

NJOHJA ME KODIN E IESBA-së

Pjesa 6: Konfliktet e Interesit



Një ndër përgjegjësitë e profesionistëve kontabël (PK) është të sigurojnë që puna që ata bëjnë dhe vendimet që ata marrin janë në interes të klientit, punëdhënësit dhe publikut, sesa bazuar në interesin vetjak. Si këshilltarë të besuar, PK-ve u kërkohet të menaxhojnë siç duhet konfliktet e interesit që lindin. Ata nuk mund të lejojnë që një konflikt të kompromentojë gjykimin e tyre profesional ose të biznesit.

Konfliktet e interesit nuk janë, në vetvete, shkelje të kodit.

PK-të janë angazhuar në mënyrë aktive në komunitetin e biznesit në një shumëllojshmëri të gjerë rolesh dhe kjo përfshirje e gjerë ndonjëherë mund të çojë në situata të lindjes së konfliktit të interesit. Është e rëndësishme të dihet se të qenurit në një situatë konflikti interesi nuk nënkupton automatikisht që një PK është në shkelje të Kodit. Konfliktet e interesit nuk janë gjithmonë të shmangshme dhe mund të krijojnë kërcënime të pajtueshmërisë me parimet themelore dhe pavarësinë. Konflikte të tilla mund të trajtohen në mënyrë efektive nëpërmjet zbatimit të kuadrit konceptual **për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet.**

Konfliktet e interesit lidhen më ngushtë me parimin e objektivitetit. Kodi ndalon të gjithë PK-të të kompromentojnë gjykimin e tyre profesional ose të biznesit për shkak të paragjyimit, konfliktit të interesit ose ndikimit të padrejtë të të tjerëve.

Konfliktet e perceptuara të interesit janë po aq të rëndësishme për tu adresuar sa ato realit. Konfliktet e perceptuara të interesit mund të ulin besimin dhe të dëmtojnë reputacionin e PK dhe të profesionit në përgjithësi. Për të vlerësuar konfliktet e perceptuara të interesit, PK-ve u kërkohet të zbatojnë [testin e palëve të treta të besueshme dhe të arsyeshme](#).




PK-të pritet që të jenë vigjilentë për ndryshimet në rrethanat (si psh aktivitetet, interesat dhe marrëdhëniet) që mund të krijojnë konflikte interesi. Kjo ndihmon për t'u siguruar që konflikte të tilla identifikohen dhe adresohen menjëherë.

SI LINDIN SITUATAT E KONFLIKTEVE TË INTERESIT


PK-të zakonisht ndeshen me konfliktet e interesit kur:

1. **Interesat e tyre personale janë në konflikt** me interesat e një klienti, punëdhënësi ose një palë tjetër për të cilën PK po punon.
2. Ka **interesa konfliktuese ndërmjet dy ose më shumë klientëve**, punëdhënëseve dhe palëve të tjera me të cilat PK po punon.

Për shembull:



Për shembull:



Kuadri Konceptual i Kodit përfshin dispozita specifike që ndihmojnë PK-të në trajtimin e konflikteve të interesit.

KU MUND TË GJENDET INFORMACIONI I NEVOJSHËM?



Tema e konfliktit të interesit është trajtuar në Seksionin **210** për PAIB-të dhe në Seksionin **310** për PAPP-të. Për më shumë informacion mbi zbatimin e Kuadrit Konceptual të Kodit, shikoni Pjesët **2**, **3** dhe **4**.



eCode, i cili është i disponueshëm në www.IESBAeCode.org është një burim on-line për profesionistët kontabël dhe përdoruesit e tjerë të Kodit. Ai siguron aksesim të shpejtë dhe eficient të Kodit, duke e bërë më të lehtë përdorimin, implementimin dhe zbatimin e tij.

ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL PËR TRAJTUAR KONFLIKTET E INTERESIT

Konfliktet e interesit rezultojnë në kërcënime ndaj objektivitetit dhe (potencialisht) ndaj parimeve të tjera themelore. Prandaj, PK-të duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të **identifikuar** situatat që mund të rezultojnë në konflikte. Për PAPP-të, procesi i identifikimit duhet të zhvillohet para fillimit të një marrëdhënie të re me klientin dhe duhet të përfshijë të gjithë rrjetin e firmës së auditimit.

Në lidhje me **vlërësimin** e nivelit të kërcënimeve të krijuara nga konfliktet e interesit, sa më shumë që të jetë e lidhur drejtpërdrejt me shërbimin ose aktivitetin profesional, aq më shumë ka të ngjarë që kërcënimi të mos jetë në një nivel të pranueshëm.

Për të **adresuar** një konflikt interesi, PK-të mund të:

- Eleminojnë konfliktin, mbase duke e larguar veten nga çdo ndikim mbi vendim-marrjen për këtë çështje;
- Aplikojnë masa mbrojtëse, të cilat shpesh përfshijnë detyrat e ristrukturimit ose shtojnë mbikëqyrjen e paanshme; ose
- Tërhiqen nga aktiviteti profesional.

Konsideratat e konfidencialitetit

Zbulimi i konfliktit dhe marrja e miratimit nga palët e prekura në lidhje me veprimet që duhen ndërmarrë është normalisht e nevojshme, por kjo mund të çojë në probleme me konfidencialitetin. Nëse zbulimi nuk është i mundshëm për shkak të problemeve të konfidencialitetit, atëherë nevojitet kujdesi i veçantë për të menaxhuar dhe dokumentuar situatën.

Në këtë rast do të jetë më mirë të eliminohet konfliktin ose të tërhiqet nga aktiviteti profesional.

Rëndësia e dokumentacionit dhe transparencës

Menaxhimi i konflikteve të interesit kërkon një gjykim dhe finesë të madhe profesionale. Dokumentimi i hapave dhe të ndërmarra është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Transparenca e përshtatshme - brenda kufijve të kërkesave të konfidencialitetit - mund të çojë në largimin e shqetësimeve dhe ruajtjen e besimit kur adresohet një konflikt interesi i vërtetë ose i perceptuar.

“Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 6: Konfliktet e Interesit”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Maj 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 6: Konfliktet e Interesit” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 6: Konfliktet e Interesit” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Exploring the IESBA Code, Installment 6 – Conflicts of Interest”

Kontakttoni Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.